



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJDIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jeditsica Org.Unit	SP-02
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	-01-
Mei Prot. Broj Prot. Prot. No.	8838-2/25
Datë: Datum: Date	23.12.25
PRISHTINË / A	
No 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of Generaly Secretary

DATË/A:	17/12/2025
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit Komuna Gjilan
CC:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zv.Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shqyrtimi i shkresës nga Komuna e Gjilanit me numër të protokollit 8838/25 të datës 15/12/2025 për dhënie të pëlqesë për Taksat e lejes ndërtimore

Të nderuar/a,

Bazuar në shkresën e datës 15/12/2025 me numër protokollit 8838/25, lidhur me caktimin e taksës administrative për leje ndërtimore dhe taksës administrative për leje rrënimi nga Komuna e Gjilanit (tutje si: Komuna), MMPHI ka shqyrtuar dhe analizuar shkresën së bashku me dokumentacionin përcjellës dhe konstaton si në vijim:

Komuna ka propozuar Taksat në pajtim me Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës.

Taksa Administrative për leje ndërtimore për kategorinë e I-rë e llogaritur nga Komuna është 0.64 €/m² (zero euro e gjashtëdhjetë e katër centë për metër katror).

Taksa Administrative për leje ndërtimore për kategorinë e II-të e llogaritur nga Komuna është 1.46 €/m² (një euro e katërdhjetë e gjashtë cent për metër katror).

Taksa Administrative për leje rrënimi e llogaritur nga Komuna për kategorinë I dhe II është 0.79€/m² (zero euro e shtatëdhjetë e nëntë centë për metër katror).

Tarifa për rritjen e densitetit të infrastrukturës është llogaritur konform Shtojcës 7 të UA Nr.02/2018 dhe kjo Tarifë duhet të llogaritet vetëm për njësit e reja të banimit.

Komuna duhet të procedoj për aprovim taksat në pajtim me procedurat e parapara me Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110.

Me respekt,